



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED  
PREMIJERA  
AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST  
POLOVA/ AGENCY OF GENDER EQUALITY

Datë: 23/10/2023  
Ret: 388/2023

## RAPORT

**Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në :**

**Subvencionimin e projekteve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.**

### Hyrje

Agjencia për Barazi Gjinore ka rishpallur thirrjen publike me dt. 26.09.2023, për financim të projekteve të OJQ-ve në zbatim të drejtpërdrejtë të Objektiva Strategjike, të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 dhe planit të tij të veprimit, respektivisht Objektiven IV Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat, respektivisht:

**Objektivi specifik IV.1 Zbatimi i politikave që mundësojnë ri integrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave të dhunës**

Veprimi IV 2.9 Subvencionimi i projekteve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

### Qëllimi

Agjencia për Barazi Gjinore përmes kësaj thirrje është në zbatim të drejtpërdrejtë të Strategjisë Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2023 dhe planit të tij të veprimit respektivisht,

Objektiven IV Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat, respektivisht:

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thirrje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendimmarrjes në përputhje me rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Agjencia për Barazi Gjinore ka pranuar aplikimet e gjithsej (katër) 4 Organizata Jo Qeveritare të cilat para vlerësimit të projekteve të tyre komisioni ka bërë kontrollin administrativ të secilit aplikacion

Lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike

1. OJQ Mundësia – Fuqizimi ekonomik i grave, investim në mirëqenien e shoqërisë
2. OJQ Zana – Ri integrimi i mbijetuarave të dhunës në familje ndërmjet fuqizimit ekonomik
3. Strehimorja “ Shtëpia e sigurt” – Fuqizimi ekonomik i të mbijetuarave të dhunës në Familje
4. OJQ Bussines Women Mitrovica në partneritete me Strehimoren Raba Voca- “Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje”

#### Vlerësimi

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar Komisionin vlerësues me nr. të vendimit 355/2023 përberë nga 3 zyrtar të ABGJ-së dhe dy anëtar/e përfaqësues nga Shoqëria Civile gje gjësisht ekspert të jashtëm, kishte për detyrë të vlerësojë të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike.


Komisioni Vlerësues sipas thirrjes publike të shpallur nga ABGJ dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, në prezencë të të gjithë anëtarëve ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe sipas kriterëve të thirrjes publike, dhe kriterëve a) kriteret e përgjithshme dhe b) kriteret specifike të cilat ishin baza për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas neneve 10 dhe 11 të rregullores MF-Nr.04/2017, nuk kalojnë në fazën e vlerësimit përmbajtësor dhe si të tilla diskualifikohen.

ABGJ për të tretën herë me radhë ka shpall thirrjen publike për mbështetje të OJQ-ve, të cilat janë vlerësuar nga komisioni dhe bazuar në vlerësimin e lartshënuar Komisioni rekomandon ABGJ-së që të shpallë thirrje të re publike, dhe të fokusohet në mbështetjen e programeve të OJQ-ve në fushën e sesibilizimit dhe ndërgjegjësimit në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në baza gjinore.

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Komisionin për ankese për subvencione në ABGJ në afatin prej 5 (pesë) dite nga data e publikimit. Ankesat duhet të dërgohen në kopje fizike në zyrat e Agjencisë për Barazi Gjinore, kati VII Ndërtesa e Qeverisë, sheshi Skënderbe.


#### Anëtarët e Komisioni

Shpresa Zariqi - Kryesuese

  
Jehona Xani -Anëtare



Yllka Kotorri-Anëtare

  
Arianit Jashari-Anëtar

Merita Shala -Anëtare



